

## Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve mjedisore nëpërmjet “Teknikave të Vëzhguesve të Trajnuar”

### Konteksti

Sipas legjisllacionit për vetëqeverisjen vendore, misioni i bashkive është qeverisja efektive, efiçente dhe në një nivel sa me afër qytetarit.

Bashkitë duhet të sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, të cilat mund ti ofrojnë në disa mënyra, të cilat janë:

- nëpërmjet ndërmarrjeve për shërbime publike
- njësisive organizative të vetë strukturës administrative të njësisë;
- kontraktim të dhënies së shërbimeve me palë të treta;
- partneritetit publik privat;
- krijimit të shoqërive tregtare (sh.a.)

Pavarësisht mënyrës se si njësitë e qeverisjes vendore i ofrojnë shërbimet, ligji ngarkon bashkitë, për **hartimin dhe vendosjen e një sistemi administrimi të performancës** së shërbimeve për të përmirësuar nivelin dhe cilësinë e ofrimit të tyre.

Ky projekt do të ndikojë direkt në perceptimin e banorëve për ofrimin e shërbimeve mjedisore nga ana e bashkive. Nga ana tjetër ky projekt do të ndihmojë njësitë e qeverisjes për arritjen e objektivave të strategjisë së decentralizimit në forcimin e demokracisë lokale nëpërmjet rritjes së gjithëpërfshirjes qytetare dhe forcimit të strukturave komunitare në nivel vendor.

### Metodologjia

#### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.



Në projekt do të përfshihen një grup vëzhguesish të cilët do të trajnohen dhe do të përdorin një sistemi të unifikuar, Teknikat e Vëzhguesve të Trajnuar (TVT), me anë të të cilit do të monitorojnë e vlerësojnë ofrimin e dy shërbimeve mjedisore:

- 1- **Shërbimin e mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta: Vlerësimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve dhe kontejnerëve.**
- 2- **Mirëmbajtja e Parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike.**

duke e dokumentuar atë me fotografi dhe me anë të formularëve të vlerësimit. Në aplikimin e kësaj metodologjie përfshihen persona të cilët janë pjesë e komunitetit, për të monitoruar e vlerësuar ofrimin e shërbimeve me një shkallë vlerësimi: shumë mirë, mirë, keq dhe shumë keq

### Produkte

- a. Krijimi i një rrjeti vëzhguesish të kualifikuar për monitorimin dhe vlerësimin e ofrimit të shërbimeve mjedisore.
- b. Mbështetja e autoriteteve lokale në

përmirësimin e ofrimit dhe financimit të shërbimeve nëpërmjet prioritizimit.

c. Përfshirjen e komunitetit në prioritizimin e nevojave për ndërhyrje.

d. Përfshirjen e gjetjeve të projektit në buxhetin e bashkive.

### FAKTET KRYESORE

#### DONATOR:

- ✓ Agjencia e Zhvillimit të Bashkëpunimit Suedez e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze në Tiranë dhe REC Albania

#### KOHËZGJATJA:

- ✓ 15 Mars 2018 – 15 Tetor 2018

#### PËRFITUES:

- ✓ Bashkia Durrës, Krullë, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë dhe Pogradec

#### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane  
Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: uri@uri.org.al  
web: www.uri.org.al